



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit / Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit

Uprava za Urbanizam, Planiranje i Zashitu Okoline

Department for Urbanism, Planning and Environmental Protection

KOMUNA RAHOVEC

RAPORT VJETOR I PUNËS

DREJTORIA PËR URBANIZËM PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

	REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC	
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET		
Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)		
Nr./Br./No <u>222</u> Nr. i faq./Br.str./No.pg <u>03</u>		
Data/Datum/Date <u>20 / 01 / 2020</u>		
RAHOVEC / ORAHOVAC		

DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, në bazë të Statutit të Komunës së Rahovecit dhe rregulloreve në fuqi, Planit të Punës për vitin 2019, gjatë periudhës njëvjeçare, ka kryer një mori aktivitete dhe punë të parapara.

Në periudhën janar – dhjetor 2019 janë shqyrtuar kërkesa të qytetarëve, janë aprovuar, janë refuzuar dhe janë ceduar sipas procedurës së aplikueshme administrative. Nga këto kërkesa janë lëshuar: Kushte ndërtimore, leje ndërtimore, leje rrënimi, leje të legalizimit, pëlqime, leje përdorimi, ndërrim-destinimi, vërtetime urbanistike, vendime, referenca, njoftime dhe shkresa të tjera. Raporti vjetor i punës për vitin 2019 është hartuar me kujdes, në mënyrë që të jetë i kompletuar dhe është i kategorizuar në periudha tre mujore.

Tremujori i parë: janar, shkurt, mars

Në fillim të janarit është shpallur tenderi, sipas planit të prokurimit, dhe në mars është lidhur kontrata për hartimin e projekteve në Komunën e Rahovecit. Gjatë këtij viti janë hartuar projektet për investime kapitale të Komunës së Rahovecit dhe të projekteve në bashkëfinancim me organizatat e tjera buxhetore: Ndërtimi i SHFMU “Liria” në Fortesë, terrenet sportive në komunën e Rahovecit, projektet për asfaltimin e dy rrugëve (Rruga Rahovec-Hamoc-Fortesë dhe Rruga Xërxë-Sapniq-Ratkoc). Është hartuar projekti për QMF-në në Çifllak, parqet në komunën e Rahovecit, rruga nga Epopeja e UÇK-së deri te Maja e Shkodranit, parkingjet në qytetin e Rahovecit, ndërtimi i çerdhes në Xërxë dhe Krushë të Madhe, ndërtimi i kullës prej guri mbi Opterushë kushtuar heronjve Xhelal Hajda – Toni dhe Selajdin Mullabazi – Mici dhe i tre bashkëlloftëtarëve të tyre dëshmorë, rruga katër korsi Rahovec – Xërxë, si dhe projekti për Zonën Ekonomike për marrjen e pëlqimeve, me qëllim licencimin e kësaj zone.

Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, në mars të këtij viti, ka propozuar që në qytetin e Rahovecit të planifikohet ndërtimi i një sheshi qendror, është propozuar lokacioni i konceptimit të sheshit, që përfshin një hapësirë prej 3 hektarë, pronë komunale e Rahovecit. Vendet që janë propozuar për krijimin e sheshit, me qëllim hapjen e zonës qendrore, janë vendet në të cilat sot ndodhen stadiumi i qytetit, tregu javor, parku i qytetit, vendi ku ka qenë Eko-Regjioni, hapësira e Hotel Parkut së bashku me parking si dhe hapësirat e tjera komunale përreth.

Në kuadër të sektorit të mjedisit janë shënuar disa aktivitete në fushën e mjedisit si: Shënimi i Ditës Botërore të Pyjeve, Ditës Botërore të Ujit, Ditës Botërore të Tokës dhe Ditës Botërore të Mjedisit dhe Ditës Botërore të Pastrimit.

Tremujori i dytë: prill, maj, qershor

Gjatë kësaj periudhe raportuese dhe tërë vitit 2019 mbikëqyrja e projekteve kapitale është bërë me kujdes nga kompania e kontraktuar. Operatori që ka për detyrë mbikëqyrjen e projekteve kapitale, vazhdimisht ka përpiluar raporte mbi punët e kryera si dhe raporte për Drejtorinë e Urbanizmit, si

menaxhere e kësaj kontrate të rëndësishme për rritjen e cilësisë të punëve dhe zbatimit të kontratave për projektet kapitale të financuara nga Komuna e Rahovecit.

Me qëllim të planifikimit dhe projektimit sa më të mirë të sheshit qendror të qytetit, Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, ka lidhur marrëveshje me organizatën ndërkombëtare që merret me planifikim urban, UN-Habitat-in, për të bashkëpunuar në krijimin e një koncepti dhe hartimit të detyrave projektuese për shpalljen e konkursit ndërkombëtar të dizajnit të sheshit. Fillimisht Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka nënshkruar një memorandum mirëkuptimi me UN-Habitat-in, me qëllim të bashkëpunimit të Komunës së Rahovecit me këtë organizatë në fushën e planifikimit hapësiror. Tani kemi përpiluar planin për mbajtjen e diskutimeve dhe analizave të nevojshme për planifikimin sa më të saktë të sheshit së bashku me UN-Habitat-in, kemi kërkuar nga KEDS-i e "KRU Gjakova" informatat për rrjetin e elektrikës, ujësjellësit dhe kanalizimit në hapësirën e propozuar për shesh, janë bërë matjet gjeodezike dhe është krijuar ekipi komunal për planifikim, ndërsa në nëntor është lidhur marrëveshje të re specifike me UN-Habitat-in për mbajtjen e konkursit ndërkombëtar të projektit ideor për sheshin qendror të qytetit të Rahovecit.

Në bashkëpunim me Drejtorinë për Shërbime Publike janë identifikuar deponitë ilegale në të gjitha vendbanimet e komunës së Rahovecit. Janë realizuar aktivitete të përbashkëta me drejtori të tjera të Komunës së Rahovecit, në pastrimin e deponive ilegale dhe aksione për pastrimin e mjedisit.

Tremujori i tretë: korrik, gusht, shtator

Është lidhur kontrata për hartimin e Hartës Zonale të Komunës së Rahovecit, poashtu, edhe në këtë proces kemi formuar një ekip nga Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit për të hartuar bashkërisht me kompaninë që ka fituar të drejtën në bazë të procedurave të prokurimit publik, kompaninë "INSI" nga Prishtina, Hartën Zonale të komunës së Rahovecit. Gjatë vitit 2019 janë marrë të gjitha informatat e nevojshme për të filluar me bazën e të dhënave, si fazë fillestare e këtij procesi. kompania e kontraktuar ka paraqitur raport për punën që ka bërë gjatë vitit 2019.

Është shpallur tenderi dhe është lidhur kontrata për hartimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis, poashtu, sipas planit të prokurimit dhe planit të punës për vitin 2019, së bashku me ekipin komunal të formuar me vendim të Kryetarit dhe kompanisë konsulte kemi paraqitur një draft të planit të hartuar dhe pas vendimit të Kuvendit të Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e fundit për vitin 2019 ka marrë vendim për shqyrtim publik të Planit Lokal të Veprimit në Mjedis. Pas shqyrtimit publik dhe kontrollimit edhe një herë të ekipit komunal së bashku me kompaninë konsulte, do t'i propozojmë Kuvendit të Komunës së Rahovecit për miratim.

Tremujori i katërt: tetor, nëntor, dhjetor

Në hartimin e Planit Zhvillimor Komunal, përveç kompanisë së kontraktuar, kemi angazhuar edhe një punëtorë për mbledhjen e të dhënave të kërkuara, të dhënat për të gjithë infrastrukturën e komunës së Rahovecit, për kanalizimet, rrugët, rrjetin elektrik etj, ndërsa tani kemi marrë pëlqimin nga Ministria e

Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, si hap i parë për të aplikuar pastaj për marrjen e pëlqimit për përputhshmërinë e Planit Zhvillimor të komunës së Rahovecit me Planin Hapësinor të Kosovës.

PROJEKTET E INVESTIMEVE KAPITALE:

- Kompleksi i Dëshmorëve në Gradish – janë shtuar punët në këtë projekt, është duke u punuar dhe është afër përfundimit;
- Renovimi dhe fasadimi i objektit për banim kolektiv – punimet kanë vazhduar sipas planit për menaxhimin e kontratës, dhe janë kryer të gjitha punët dhe është pranuar teknikisht nga komisioni përgjegjës;
- Rregullimi i shtratit të lumit në Krushë të Madhe – punimet kanë vazhduar, poashtu, ka pasur ndërprerje për shkak të problemeve me kolektorë të ujërave të zeza që janë derdhur në këtë lum, është zgjidhur problemi dhe kompania e kontraktuar ka vazhduar punimet dhe janë realizuar punime sipas planit për menaxhimin e kontratës;
- Krijimi i hapësirave të gjelbëruara dhe mbjellja e drunjve dekorativ – punimet me këtë projekt janë përmbyllur, janë pranuar të gjitha situacionet dhe raportet e mbikëqyrjes. Poashtu, në pjesën e dytë të vitit 2019 është shpallur tenderi në dy lote për krijimin e hapësirave të gjelbëruara, një për krijimin e tetë parqeve të reja dhe një lot për mbjelljen e 10 mijë drunjve. Punët në parqet janë filluar në: Pataqan të Poshtëm, Dobidol, Malësi e Vogël, Sapniq dhe Senoc, ndërsa loti për mbjelljen e drunjve momentalisht është në Organin Shqyrtues të Prokurimit pas ankesës që ka bërë njëri nga operatorët;
- Rregullimi i shtratit të lumit në Zoqisht – punimet kanë përfunduar dhe është bërë raporti përfundimtar i pranimit teknik nga ana e komisionit të formuar për këtë çështje;
- Ndërtesa për banim social – për shkak të borxheve në këtë projekt, s'kemi arritur ta përfundojmë në këtë vit, mirëpo këtë vit synojmë ta përmbyllim në vitin 2020;
- Busti për dëshmorin Mustafë Ibishi – është vendosur në oborrin e shkollës që mban emrin e këtij dëshmori;
- Është shpallur tenderi dhe janë rregulluar varrezat e dëshmorëve dhe martirëve në fshatin Dejnë, sipas kontratës së lidhur;
- Shtatorja e Shejh Myhedin Shehut është vendosur në vendin e përcaktuar me vendim të Kuvendit në përvjetorin e rënies së Heroit të Kosovës;

- Është shpallur konkursi për ndërtimin e shtatores së Heroit të Kosovës Feim Gashi, tani ka mbetur vetëm shkrirja në bronz dhe do të vendoset gjatë vitit 2020 së bashku me shtatoren e vëllait Hero të Kosovës, Bedrush Gashi, në fshatin Drenoc;
- Është shpallur tenderi dhe është lidhur kontrata për ndërtimin e kullës prej guri për heronjtë Toni dhe Mici te vendi i rënies mbi fshatin Opertushe. Punimet kanë filluar dhe janë duke vazhduar, ky projekt do të përfundojë gjatë vitit 2020;
- Është lidhur kontrata për rregullimin e shtretërve të lumenjve nga Hoça e Madhe, Brestoc, Hoçë e Vogël, Nagac deri në Krushë të Madhe. Ky projekt i ndarë në dy lote është financim i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ndërsa menaxhohet nga Komuna e Rahovecit, përkatësisht Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit;
- Në bashkëfinancim me komunitetin e fshatit Guri i Kuq, ka filluar ndërtimi i lapidarit “Altari i Lirisë” kushtuar të rënëve të këtij fshati.

Drejtori i DUPMM-së

Rumir Zhuniqi

